



Pranimar / Dorezuar Punësimi / Prodato Receipt / Delivery		18.07.2022	2	viti god year
Organ / Shërbimi Org / Unit	Drejtoria / Dir. Prot. Prot. No	Shtesa / Protog. Appendix	Sasia Kohëzina Quantity	
SKPM/SHCK	4186/2022		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.523/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Kocanëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 523/2022, të datës 13.06.2022, të ankuesit

me adresë banimi

kundër organit të punësimit

Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "Kompensimi Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 18.07.2022, mori këtë;

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.523/2022 e datës 13.06.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me nr. 108 i datës 04.03.2022 i zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, me datë 04.03.2022 ka nxjerr Vendim me numër 108 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësin civil Agim Retkoceri, duke i njohur të drejtën e një page përcjellëse në rastin e pensionimit.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër 108 të datës 04.03.2022 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, me datë 13.06.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, me pretendimet ankimore se organi i punësimit me rastin e pensionimit të tij duhet ti bëjë pagesën e tri (3) pagave, pas arritjes së moshës së pensionimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesën e ankuesit e ka dërguar tek Administrata Tatimore e Kosovës për përgjigje në ankesë me datë 17.06.2022, ndërsa me datën 27.06.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës, me provat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.523/2022 me numër të protokollit 3400/2022 ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 04.04.2022; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile i A.R. me nr. E25944191 i datës 01.03.2022; Transakcionet e konsumatorit A.R. i datës 01.01.2022 – 31.12.2022; Aplikacion për tërheqje të kursimeve pensionale i A.R. i datës 28.03.2022; Konfrimim për llogari aktive nga BKT e A.R. i datës 28.03.2022; Kërkesë për pension bazë e A.R.; Lajmërim për përfundimin e shërbimit me rastin e pensionimit nr. 442 i datës 28.10.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 17.06.2022; Përgjigje në ankesë e datës 27.06.2022; Akt Emërimi i A.R. i datës 11.12.2013; Lista e pagave e muajit shkurt 2014; Vendim me nr.108 i datës 04.03.2022; Lista e pagave e muajit mars 2022 që vërteton kompensimin e pagës përcjellëse pas pensionimit; E-mail nga V.S. për C.Z. i datës 08.07.2022; E-mail nga C.Z. për T.M. i datës 07.07.2022;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës parasheh që punëtorëve ju takon pagesa në lartësi prej dy paga përcjellëse dhe tri pagave jubilarë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”*, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: *“Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës”*, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: *“Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”*, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes.

Meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017 Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshëm, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka konstatuar se marrëdhënia e punës së ankuesit me rastin e pensionimit i ka përfunduar sipas Vendimit me numër 108 të datës 04.03.2022, atëherë kompensimi i tri pagave me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë sipas Marrëveshja Kolektive e Kosovës nuk mund të bëhet.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të listës së pagave për muajin mars 2022 ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës ankuesit i ka bërë kompensimin e një page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit, sipas dispozitave të nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të

Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: *“Paragrafi 1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit”. Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit”,* rrjedhimisht Administrata Tatimore e Kosovës ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 108 të datës 04.03.2022 ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 22 paragrafi 2.2. të Ligjit Nr.03/147 për Pagat e Nëpunësve Civil në Republikën e Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR.523/2022

Çlirim ZEKA

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

Ankuesit

Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;

Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;

Arkivit të KPMSHCK-së

